



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTE I SHTETIT KRYETARI

Nr. 881/7 Prot.

Tiranë, më 10.10.2018

V E N D I M

Nr. 157, Datë 10.10.2018

PËR

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE”
(OSHEE) NJESIA VLORE PER VERIFIKIMIN E ANKESEN NR. 881 DATE
24.07.2018, PËR PERIUdhËN NGA DATA 17.09.2018 DERI MË DATËN 13.09.2018**

Nga auditimi i ushtruar në OSHEE Sha Njësia Vlorë për verifikimin e ankesës së qytetarit z. L.K, drejtuar KLSH, administruar me praktiken nr. 881 datë 24.07.2018, rezultuan mangësi në lidhje me ndërprerjen e energjisë për qytetarin (abonentin), si dhe në lidhje me administrimin e asetëve në pronësi të Shoqërisë.

Pasi u njoha me rezultatet e auditimit të kryer në zbatim të autorizimit nr. 881/5 datë 13.09.2018 të Kryetarit të KLSH-së e paraqitur nga audituesit e Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të Ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Linja e ndërtuar në vitin 2008, nga lagjja Resulaj deri tek banesa e z. L.K rezulton e pa përfshirë në asetet e shoqërisë, si dhe deklarohet se nuk ka dokumentacion ku të përcaktohet se është ndërtuar nga ana e OSHEE. Nga ana e OSHEE Njësia Vlorë nuk vërtetohet se linja është ndërtuar nga z. L.K, por mjaftohet me faktin se linja nuk është regjistruar në asetet e shoqërisë. Nga ana e Drejtorit të OSHEE Njësia Vlorë, është paraqitur dokumentacioni, kërkesë nr. 5748 prot., datë 20.09.2018 drejtuar Drejtorisë Rajonale Fier, në lidhje me dokumentacionin e linjës. Kërkesës i është kthyer përgjigje sipas shkresës nr. 3319 prot., datë 20.09.2018, ku përshkruhet se nga kontrolli i dosjeve të ruajtura në Degën Teknike të Drejtorisë Rajonale Fier, nuk u gjend asnjë dokument mbi investimin në Lagjen "Resulaj", Selenicë. Nga ana e OSHE Njësia Vlorë nuk janë bërë përpjekje për gjetjen e dokumentacionit pranë arkivave të kësaj shoqërie, apo të arkivave të OSHEE Tiranë, por është mjaftuar me të dhënat e degës teknike të Njesisë Fier.

1.1.-Rekomandimi: - Nga ana e OSHEE, të merren masa për verifikimin e dokumentacionit të linjës nga Resulaj deri tek banesa e z. L.K duke filluar nga periudha e ndërtimit, në lidhje me aplikimin, materialet e përdorura nga shoqëria për ndërtimin e saj etj., me synim formalizimin e kësaj linje.

1.2. Rekomandimi: Pas rezultateve të nxjerra nga dokumentacioni, të merren masa për ngritjen e komisioneve përkatëse, për regjistrimin e këtyre aseteve në inventarët e shoqërisë.

Brenda datës 31.12.2018

2. Gjetje nga auditimi: Linja është ndërtuar me materiale në kundërshtim me rregullat teknike (referuar procesverbalit të ndërprerjes së energjisë elektrike) të parashikuara nga legjislacioni i furnizimit me energji elektrike, por ky fakt nuk ka ndikuar për furnizimin me energji elektrike të abonentit tjetër ndërmjetës, të cilit i është ndërprerë energjia elektrike, por i është lidhur përsëri, me argumentimin se kanë garantuar që për një kohë të caktuar do të marrin masa për sjelljen e linjës në kushte teknike, pavarësisht se furnizohen nga e njëjta linjë e cila konsiderohet jashtë kushteve teknike.

2.1. Rekomandimi: - Administratori i OSHEE, të kërkojë nga vartësit e tij, verifikimin dhe marrjen e masave të duhura për sjelljen e linjës në kushte teknike, me synim parandalimin e aksidenteve të mundshme, nga kontaktet me energjinë elektrike.

Brenda datës 31.12.2018

2.2. Rekomandimi: - T'i kërkohet administratorit të OSHEE Njësia Vlorë, zbatimi i ligjit në mënyrë të barabartë për të gjithë abonentët e saj dhe jo në mënyrë selektive, duke vepruar me dy standarde.

Vazhdimisht

3. Gjetje nga auditimi: Bazuar në të dhënat e sistemit elektronik, abonenti L.K zotëron kontratë të rregullt, sahat matës të vulosur nga OSHEE, madje edhe të rivulosur në vitin 2013, 2015 dhe 2017, si dhe ka likuiduar rregullisht faturat e energjisë. Ndërprerja e furnizimit me energji elektrike për këtë abonent me argumentin e mos plotësimit të kushteve teknike duke e konsideruar linjën pronë të tij, nuk është vërtetuar me

dokumentacionin që duhet të paraqitet në këtë rast nga abonenti në OSHEE. Deklarohet se nuk ka dokumentacion në lidhje me aplikimin, projektimin, marrjen në dorëzim nga OSHEE për këtë linjë, pra nuk vërtetohet se linja është ndërtuar nga z. L.K. Fakti që në këtë linjë nga ana e OSHEE janë lidhur edhe abonentë të tjerë, veprim i cili nuk mund të kryhej pa miratimin e pronarit, përforcon faktin se kjo linjë është shoqëruar me problematika të tjera që shtrihen në kohë.

3.1-Rekomandimi: OSHEE SHA të verifikojë praktikën e ndjekur për dhënie e lejeve për lidhje energjie në një linjë e cila nuk plotëson kushtet teknike, duke vënë para përgjegjësisë personat përgjegjës.

3.2 Rekomandimi: Të merren masa për shqyrtimin e lejeve të dhëna edhe për linja të tjera të cilat furnizojnë me energji elektrike abonentë të ndryshëm, të cilat po ashtu nuk plotësojnë kushtet teknike.

Brenda datës 31.12.2018

4. Gjetje nga auditimi: Abonentit z. L.K, i është ndërprerë energjia sipas procesverbalit të punonjësve të OSHEE nr. 113203, datë 04.08.2017. Po ashtu, me procesverbal nr. 113202, datë 04.08.2017, i është ndërprerë energjia elektrike abonentit privat “H.I” Sh.p.k, i cili furnizohet në këtë linjë. Në observacionet e paraqitura nga Administratori i OSHEE Njësia Vlorë nr. 5739/1 prot., datë 26.09.2018, përcaktohet që: *“Përfaqësuesit e shoqërisë “H.I” Sh.p.k, pasi i’u ndërpre energjia, u paraqitën në zyrën e OSHEE Njësia Vlorë, konfirmuan parregullsitë e konstatuara në procesverbal dhe kërkuan kohën e mjaftueshme për sistemimin e situatës, dhe më pas ndërmori masat duke ndërruar shtyllat metalike duke i sjellë brenda kushteve teknike të kërkuara, me shpenzimet e përdoruesit të saj (referuar rregullores së linjave të reja)”*. Nga verifikimi i bërë përgjatë linjës nga audituesit e KLSH, Drejtori i Njesisë, kryeinxhinieri dhe elektrikisti i zonës me datë 19.08.2018, rezultoi se energjia elektrike përcillej në po të njëjtën linjë dhe po me të njëjta shtylla, pra metalike. Nga ana e OSHEE, Njësia Vlorë, është vepruar në mënyrë selektive për rilidhjen e energjisë elektrike.

4.1.Rekomandimi: Nga ana e OSHEE Njësia Vlorë, të merren masa për rilidhjen e energjisë elektrike për abonentin z. L.K, duke qenë se furnizohen nga e njëjta linjë me abonentin e rilidhur, si dhe ka kontratë të rregullt me OSHEE dhe ka likuiduar rregullisht pagesat e energjisë elektrike të konsumuar nga ana e tij.

Brenda 10 ditësh

B. TE TJERA

Në rast se nga OSHEE SHA Njësia Vlorë, nuk do të merren masa për rilidhjen e linjës për të bërë të mundur furnizimin me energji elektrike të abonentin z. K brenda afatit të përcaktuar në rekomandimin 4.1, për Drejtorin e Njesisë OSHEE Vlorë do t’i kërkojmë Administratorit të OSHEE SHA të marrë masën disiplinore “Largimin nga detyra”, si dhe do të sugjerojmë trajtimin e detajuar tekniko-juridike nga Departamenti Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës për të evidentuar element të veprës penale bazuar në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja. Ky vendim përcillet në formë rekomandimi në subjektin e audituar.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R